



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0197

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi - Brajshori dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë” me numër të prokurimit 632-25-1362-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”, më 07/05/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e pabazuar ankesa e “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P. K me nr. 2025/0197, e datës 24/03/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, me numër të prokurimit 632-25-1362-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA E GJAKOVËS”.

2. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, me numër të prokurimit 632-25-1362-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA E GJAKOVËS” të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 28.02.2025, “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë” me numër të prokurimit 632-25-1362-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontrates: 649,941.40 €.

Me 10.03.2025, OE “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24/03/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K me nr. 2025/0197 lidhur me aktivitetin “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë” me numër të prokurimit 632-25-1362-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori F.konomik “JOOS & KRASMIQI - BAZE SH.P.K....me dt. I 1.03.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhnr me aktivitetin e prokurimit ‘•Ndërtimi rikonstruktimi i rruges Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25- 014-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.03.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Pretendimi juaj është pjesërisht i bazuar dhe në këtë pikë Autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e dosjes së lenderit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Në datën 10.03.2025, kemi paraqitur një kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, duke paraqitur faktet dhe dëshmitë që tregojnë se është bërë shkelje e ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore, me kritere të përcaktuara në dosjen e tenderit, në njoftimin për kontratë, si dhe në specifikimet teknike nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Në datën 12.03.2025, kemi pranuar vendimin nga ana e autoritetit kontraktues, me të cilin pranohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim dhe bëhen ndryshime në dosjen e tenderit.

Megjithatë, këto ndryshime nuk përmbushin as minimalisht kërkesat e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik në rastin konkret. Po ashtu, në vendim nuk janë dhënë sqarime lidhur me pretendimet ankimore të bëra ndaj autoritetit kontraktues, dhe për më tepër, janë shtuar disa

certifikata të panevojshme dhe diskriminuese për projektin në fjalë, të cilat janë:

- ISO 28001:2007 - Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë në Zinxhirin e Furnizimit.
- PASS 99:2012 - Sistemi i Menaxhimit të Integruar.
- IEC 27001:2013 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.
- SA 8000:2014 - Sistemi i Menaxhimit të Përgjegjësisë Shoqërore.

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Ankesës

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), parashtrojmë Ankesë ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, Komuna Gjakovë të datës 12.03.2025 konkretisht ndaj kërkesave dhe specifikave të tenderit dhe kriterëve të vlerësimit në tenderin e shpallur me emër: Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë: 632-25-1362-5-1-1.

Ankesa do të fokusohet në kriteret e atakuara nga ana e jonë si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht piken 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (pesdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si në vijim a.)Një (1) Menaxher i Projektit - Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master inxhinier i ndërtimit, drejtimi konstruktiv, minimum 5 vite përvojë pune. b.)Një (1) Udhëheqës i punishtës - Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit - Drejtimi Hidroteknik i certifikuar për menagjimin e resurseve ujore,sasi, cilësi dhe shëndet në punë, minimum 5 vite përvojë pune pas certifikimit. c.)Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master inxhinier i ndërtimit drejtimi Gjeodezi, të ketë licencë të lëshuar nga Agjensioni Kadastral i Kosovës. Ç.)Një (1) Inxhinier i diplomuar ose master i komunikacionit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në vazhdim do të paraqesim faktet dhe argumentet tona, si dhe shkeljet e mundshme të dispozitave ligjore nga ana e autoritetit kontraktues në këtë pike:

Kriteri që kërkon një udhëheqës të punishtës me diplomë në Inxhinieri Ndërtimi ose Bachelor në këtë fushë, dhe përvojë pune për menaxhimin e resurseve ujore, cilësinë dhe shëndetin në punë, mund të duket jo shumë relevant për një tender me emrin "Rehabilitimi i rrugëve me asfalt", për disa arsye:

1.Përvoja dhe Kualifikimi: Një inxhinierndërtimi me kualifikim të tillë ka ekspertizë të vlefshme për projekte ndërtimi, për një projekt të rehabilitimit të rrugëve me asfalt, fokusi do të ishte më shumë në menaxhimin e punimeve të asfaltimit, infrastrukturës dhe sigurisë rrugore, sesa menaxhimi i resurseve ujore. Përvoja që kërkohet në menaxhimin e resurseve ujore dhe shëndetit në punë është e nevojshme dhe diskriminuese për këtë lloj projekti.

2.Kualifikimet e Duhura për këtë Lloj Projekti: Pavarësisht se një inxhinier i diplomuar është një kërkesë e zakonshme për projekte ndërtimi, mund të ishte më e përshtatshme që kriteret e kërkuara të ishin më të orientuara drejt eksperiencës në ndërtimin e rrugëve, menaxhimin e materialeve të asfaltit, dhe njohuritë teknike për teknologjitë e asfaltimit dhe infrastrukturën.

Ky kriter është i tepruar për një projekt të tillë dhe duhet të rishikohet për t'u fokusuar në aftësitë dhe përvojën që lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, dhe jo aq shumë me menaxhimin e resurseve ujore, cilësinë dhe shëndetin në punë, që janë më të rëndësishme për projekte të tjera.

Kriteri që kërkon një "udhëheqës të punishtës - inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose bachelor i inxhinierisë së ndërtimit - drejtimi hidroteknik i certifikuar për menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet në punë, minimum 5 vite përvojë pune pas certifikimit" është po ashtu në kundërshtim të rreptë me Ligjin e Prokurimit Publik, për disa arsye:

1.Relevanca e Kriterit: Ligji i Prokurimit Publik, kërkon që kriteret për selektimin e operatorëve ekonomikë të jenë të drejtpërdrejta dhe të lidhura me objektin e kontratës. Në këtë rast, kriteri që lidhet me menaxhimin e resurseve ujore dhe shëndetin në punë është jo i drejtpërdrejtë për një tender që ka për qëllim rehabilitimin e rrugëve me asfalt. Në një projekt për rehabilitimin e rrugëve, më shumë do të kishte kuptim që kriteret të fokusohen në përvojën e punës në ndërtimin e rrugëve, menaxhimin e materialeve të asfaltit, dhe menaxhimin e punëve të ndërtimit, sesa menaxhimi i resurseve ujore dhe shëndetit në punë.

2.Përjashtimi i Operatorëve të Tjerë: Ligji i Prokurimit Publik gjithashtu kërkon që kriteret e kërkuara të mos përjashtojnë pa justifikim operatorët ekonomikë të cilët mund të plotësojnë kërkesat për realizimin e kontratës. Kërkesa për një "udhëheqës të punishtës" me aftësi dhe certifikime të veçanta për menaxhimin e resurseve ujore mund të kufizojë konkurrencën dhe të përjashtojë operatorë të tjerë që mund të kenë përvojë të mjaftueshme për realizimin e projektit të rehabilitimit të rrugëve, por që nuk janë të certifikuar për menaxhimin e resurseve ujore.

3.Mungesa e Transparencës dhe Justifikimit: Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, autoritetet kontraktuese duhet të justifikojnë dhe argumentojnë se pse janë të nevojshme kërkesa të tilla dhe se si ato janë të lidhura me objektin e kontratës. Në këtë rast, mund të mos ketë një justifikim të mjaftueshëm për kërkimin e një kualifikimi të tillë për menaxhimin e resurseve ujore në një tender për asfaltim të rrugëve.

Për këto arsye, ky kriter i vendosur në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit konsiderohet i papërshtatshëm dhe i tepërt për këtë lloj projekti dhe po ashtu përbën shkelje të rregullave të Ligjit të Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të gjitha kriteret janë të drejtpërdrejta, të arsyeshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, për të siguruar një proces të ndershëm dhe konkurrues.

Ne po të njejtin kriter kemi vërejtur se në kërkesat e stafit, janë përcaktuar kërkesa të papërshtatshme dhe të kufizuara për pozitat e inxhinierëve, duke përfshirë:

- a.) 1 (një) Menaxher i Projektit - Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master i inxhinierisë në ndërtim, drejtimi konstruktiv, me minimum 5 vite përvojë pune.
- b.) 1 (një) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
- c.) 1 (një) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në këtë rast, kërkesat për tri pozita inxhinierike janë të njëjta, me të njëjtën përvojë pune, të njëjtin drejtim të specializimit dhe të njëjtin nivel arsimimi (inxhinier i diplomuar ose Master në inxhinieri ndërtimi). Kjo është një kërkesë tepër e kufizuar dhe krijon kushte diskriminuese për pjesëmarrësit e mundshëm, pasi nuk ka ndonjë justifikim të qartë që kërkohen tre inxhinierë të cilët mbajnë të njëjtën përvojë dhe kualifikime. Ky është një kufizim i konkurrencës dhe mund të çojë në kufizim të pazakontë të mundësive të tenderimit.

Mungesa e justifikimit për vendosjen e këtij kriteri:

Nuk është ofruar asnjë argument apo justifikim i qartë nga autoriteti kontraktues përse kërkohen tre pozita të tilla me kualifikime dhe përvojë të njëjtë. Në mungesë të një shpjegimi të qartë dhe të arsyeshëm, kjo krijon një dyshim të fortë se kriteret janë vendosur për të favorizuar operatorë të caktuar dhe për të kufizuar mundësitë e pjesëmarrësve të tjerë, duke minuar kështu parimet e barazisë dhe transparencës në procesin e tenderimit.

Kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të rishikojë dhe modifikojë këto kërkesa, duke u siguruar që të mos ekzistojnë kërkesa që kufizojnë konkurrencën në treg dhe që i japin mundësi të barabarta të gjithë operatorëve të interesuar.

Kundershtimi ndaj kriterit kufizues dhe diskriminues për ISO

Për asfaltimin e një rruge, kërkesa për ISO 28001:2007, PASS 99:2012, IEC 27001:2013, dhe SA 8000:2014 konsiderohet tepruar dhe e papërshtatshme. Këto standarde janë të

lidhura me menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit, menaxhimin e integruar, sigurinë e informacionit dhe përgjegjësinë shoqërore, të cilat janë të rëndësishme për industria të tjera, por nuk janë të drejtpërdrejta për punimet e asfaltimit.

Pse këto standarde janë të tepruara për asfaltimin e rrugëve:

1.ISO 28001:2007 dhe IEC 27001:2013 janë të fokusuara në menaxhimin e sigurisë në zinxhirët e furnizimit dhe sigurinë e informacionit, që janë më të përshtatshme për sektorë si IT, logjistikë dhe furnizim, por nuk janë të nevojshme për një projekt asfaltimi, ku fokusimi kryesor është kryerja e punimeve infrastrukturorë dhe ndërtimi.

2.PASS 99:2012 është një standard për menaxhimin e integruar, që lidhet me menaxhimin e sistemeve të ndryshme në një organizatë, ndërsa për asfaltimin e një rruge, një menaxhim i thjeshtë i cilësisë dhe sigurisë është i mjaftueshëm.

3.SA 8000:2014 ka të bëjë me përgjegjësinë shoqërore, e cila është e rëndësishme për organizatat që operojnë në industri të caktuara, si prodhimi dhe shërbimi, por që nuk është e domosdoshme për projekte si asfaltimi i rrugëve, ku kërkohen standarde të tjera si ato të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë në punë.

Kërkesa për këto standarde konsiderohet diskriminuese dhe kufizuese, duke favorizuar operatorët që mund të përmbushin këto kriteret të veçanta, edhe pse ato nuk janë të nevojshme për përfundimin e projektit të asfaltimit të rrugëve. Përcaktimi i standardeve të tilla mund të shmanjë pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë që mund të ofrojnë shërbime të cilësisë së kërkuar, por pa këto certifikata të veçanta. Kërkohet një rishikim i kërkesave për të siguruar që ato të jenë në përputhje me natyrën e projektit dhe të mos kufizojnë konkurrencën e drejtë.

Kriteri tjetër që konsiderojmë se është kriter diskriminues është:

Aneks 7 - Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve:

Pika 2 në Aneksin 7 - Buldozer 25 deri 26 t -

Kriteri i tonazhit të buldozerit 25 deri në 26 tonë mund të konsiderohet diskriminues për disa arsye:

1.Kufizimi i konkurrencës: Diferenca në tonazh (për 1 ton) është shumë e vogël dhe nuk ka ndikim të dukshëm në performancën e makinerisë. Kjo mund të çojë në uljen e numrit të operatorëve ekonomikë që mund të konkurrojnë për tenderin, duke kufizuar mundësinë e pjesëmarrjes së kompanive të tjera që mund të ofrojnë makineri me tonazh më të lartë ose më të ulët. Një kriter i tillë nuk mund të justifikojë domosdoshmërinë për të kërkuar një tonazh të ngushtë, duke pasur parasysh që makineritë me tonazhe të ndryshme mund të kenë të njëjtin efekt operativ.

2.Përshtatja e kërkesës për operatorë të caktuar: Ky kriter mund të krijojë mundësi për përshtatje të kërkesës për disa operatorë ekonomikë, të cilët ndoshta kanë buldozerë me tonazh të specifikuar, duke krijuar një avantazh të padrejtë për ata.

Kjo mund të krijojë një situatë ku vetëm disa kompani të caktuara mund të plotësojnë kërkesat, duke e bërë konkurrencën më të kufizuar dhe duke favorizuar disa operatorë mbi të tjerët.

3.Ndarja e pazakontë e tregut: Duke i kërkuar një tonazh të ngushtë, mund të krijohet një ndarje e pazakontë e tregut, ku vetëm një grup operatorësh mund të ofrojnë shërbimet, duke krijuar një monopol të mundshëm në fushën përkatëse. Ky është një praktikë që mund të shkelë parimet e konkurrencës të shëndetshme dhe mund të çojë në rritjen e çmimeve dhe uljen e cilësisë së shërbimit.

4.Kriter i paarsyeshëm dhe i tepruar: Në shumë raste, tonazhi i buldozerit nuk është një faktor kyç për arritjen e rezultateve të kërkuara në një tender. Pra, kërkesa për një gamë kaq të ngushtë të tonazhit mund të jetë një kufizim i tepruar që nuk është i justifikuar nga natyra e projektit dhe nga kërkesat teknike që lidhen me të.

Në këtë mënyrë, kriteri mund të konsiderohet diskriminues pasi krijon kushte të padrejta për konkurrencën dhe mund të dëmtojë procesin e prokurimit publik duke favorizuar operatorë të caktuar, duke i kufizuar mundësitë e pjesëmarrësve të tjerë.

Pika 3 në Aneksin 7 Buldozer deri 111 - Kjo kërkesë paraqet një kufizim të konkurrencës, sidomos në lidhje me kërkesën për dy buldozer të tillë, kur kemi të bëjmë me një rrugë lokale. Ky kufizim është mjaft diskriminues dhe i tepruar, duke krijuar pengesa për pjesëmarrësit e mundshëm në tender, dhe ndikon në lirinë e konkurrencës.

Pikat 4-9 “Eskavator” në Aneksin 7

Kërkesa për 22 eskavatorë në një tender për rehabilitimin e një rruge është një kërkesë e tepërt dhe mund të konsiderohet si një kufizim i konkurrencës dhe si shkelje e ligjit të prokurimit publik. Në këtë kontekst, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të ofrojë sqarime të detajuara nga ekspertë të fushës për të shpjeguar pse janë të nevojshëm kaq shumë eskavatorë për një

projekt të tillë, veçanërisht kur vlera e parashikuar e tenderit është 649,941.40€. Ky numër i madh eskavatorësh ka një tonazh të papërballueshëm për shumicën e kompanive të disponueshme në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe përbën një kërkesë të paprecedentë. Asnjëherë më parë autoritetet kontraktuese nuk kanë vendosur kërkesa të tilla për një projekt të tillë.

Kriteret për eskavatorë të specifikuar në tender janë:

- Eskavator minimum 29t max. 33t - 2 copë
- Eskavator minimum 25t max 27t - 5 copë
- Eskavator me superstrukturë rrotulluese 19 deri 22t - 2 copë
- Eskavator me rrota minimum 16t max 24t - 5 copë
- Eskavator minimum 5t max 7t - 5 copë
- Eskavator me superstrukturë rrotulluese minimum 13t max 16t 3 copë

Arsyet përse këto kriterë konsiderohen diskriminues:

1.Përfashtimi i mundësive të kompanive me pajisje më të vogla: Kriteret e përcaktuara për eskavatorë si minimum 29t dhe deri në 5 eskavatorë të tillë, përfashtojnë mundësinë që kompanitë që disponojnë eskavatorë me kapacitet më të vogël, por të përshtatshëm për realizimin e këtij projekti, të marrin pjesë në tender.

Ky kriter i ngushtë krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë makineri të përshtatshme dhe që mund të përmbushin kërkesat e projektit. Kjo mund të jetë një mundësi për të përshtatur kërkesat për disa kompani të caktuara, duke i eliminuar konkurrentët tjerë.

2.Nevoja e arsyeshme për 22 eskavatorë: Nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm në tender që të justifikojë nevojën për një numër kaq të madh eskavatorësh (22) për një rrugë lokale. Kjo kërkesë është tepër e papritur dhe ka shumë mundësi që të jetë e padëshirueshme dhe e panevojshme për natyrën e projektit. Kjo rrit mundësinë për abuzim dhe favorizim të operatorëve që mund të përmbushin këto kërkesa të tepruara.

3.Shkelja e parimeve të prokurimit publik: Ky kriter shkel parimet e barazisë dhe transparencës të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, pasi favorizon ofertuesit që disponojnë eskavatorë të caktuar dhe përjashton ato kompani që mund të ofrojnë shërbim të njëjtë cilësie, por me pajisje të ndryshme. Kjo e zvogëlon mundësinë e konkurrencës dhe krijon kushte të padrejta për ofertuesit që mund të kenë pajisje më të vogla, por të përshtatshme për realizimin e projektit. Kjo mund të çojë në ndarjen e pazakontë të tregut dhe rritjen e mundësisë për monopolizim.

Në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe praktikën më të mirë të transparencës dhe barazisë në procedurat e tenderimit, kërkojmë që ky kriter të rishikohet dhe të ndryshohet, duke siguruar që të mos diskriminohen ofertuesit që mund të kenë pajisje të ndryshme, por të përshtatshme për realizimin e projektit.

Kërkojmë që autoriteti kontraktues të ofrojë një shpjegim të detajuar mbi nevojën e saktë për një numër të tillë eskavatorësh dhe të sigurojë që kriteret e përdorura të jenë në përputhje me nevojat

reale të projektit, duke e mbajtur konkurrencën të hapur dhe duke eliminuar çdo mundësi për favorizim të padrejtë të operatorëve të caktuar.

Pikat 10-13 në Aneksin 7

Kjo kërkesë, përveç se është në sasinë e kërkuar e kundërligjshme dhe e tepruar, kufizon konkurrencën dhe është e përshtatur. Ajo që është edhe më shqetësuese është diferenca që parashikohet dhe kufizimet në tonazhin e të njëjtëve, si dhe sasia e cilindrave të kërkuar prej 8 cilindrave.

a.Cilindra rrota të kombinuara (gome-hekur) minimum 2, maksimum 3t - Duhet të specifikohet rëndësia e rrotave të kombinuara, po ashtu minimumi dhe maksimumi i tonazhit, si dhe sasia e kërkuar për rastin konkret (dy cilindra).

b.Cilindra me rrota të kombinuara (gome-hekur) 8 deri në 9t - Duhet të specifikohet rëndësia e rrotave të kombinuara, po ashtu minimumi dhe maksimumi i tonazhit, si dhe sasia e kërkuar për rastin konkret (nje cilinder).

c.Cilindra me rrota të kombinuara (gome-hekur) 12 deri në 17t - Duhet të specifikohet rëndësia e rrotave të kombinuara, po ashtu minimumi dhe maksimumi i tonazhit, si dhe sasia e kërkuar për rastin konkret (dy cilindra).

d.Cilindra me rrota hekuri me vibrim 4 deri në 5t - Në këtë pikë kemi një kufizim të paraparë në tonazh, përcaktim të rrotave, dhe ajo që është më shqetësuese është kërkesa për një sasi prej tre cilindra. Ky është një kufizim dhe përshtatje e paprecedentë, dhe kërkojmë një arsyetim të mirë të detajuar për këtë rast nga ana e autoritetit kontraktues.

Pika 14 në Aneksin 7

Pika 26 në Aneksin 7 - "Minirul 2 deri në 2.5t"

Përcaktimi i një intervali të tonazhit, siç është "Minirul 2 deri në 2.5t", për një makineri të caktuar, mund të përbëjë një kufizim të padrejtë të konkurrencës dhe është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e prokurimit publik për disa arsye:

1.Kufizimi i konkurrencës: Përcaktimi i një intervali të ngushtë, duke kërkuar një makineri me tonazh të kufizuar (nga 2 deri në 2.5 tonë), mund të çojë në përjashtimin e operatorëve ekonomikë që disponojnë minirula me tonazh më të madh ose më të vogël, por që janë po aq të afta për të realizuar projektin. Kjo do të zvogëlojë mundësitë për konkurrencë të hapur dhe do të favorizojë kompanitë që kanë pajisje që përputhen ngushtë me këtë interval, duke ndaluar pjesëmarrës të tjerë që mund të kenë pajisje të ndryshme, por të përshtatshme për projektin.

2.Diskriminimi i operatorëve të mundshëm: Ky kriter mund të përjashtojë operatorët që kanë pajisje të përshtatshme për projektin, por që nuk përputhen me këtë interval të ngushtë të tonazhit. Për shembull, një operator mund të ketë një minirul me tonazh 2.6 tonë, e cila mund të jetë gjithashtu e përshtatshme për realizimin e punimeve, por nuk mund të konkurojë për shkak të kufizimeve të imponuara nga ky kriter.

3.Mungesa e arsyeshmërisë për një kufizim të tillë: Në shumë raste, kërkesa për një gamë kaq të ngushtë të tonazhit mund të mos jetë e nevojshme për realizimin e projektit. Nëse makina është e përshtatshme për llojin e punës që duhet të bëjë, tonazhi nuk duhet të jetë një faktor kufizues.

Kjo mund të jetë një praktike që favorizon operatorët që ndoshta kanë pajisje specifike, por që është e panevojshme për natyrën e projektit.

4.Shkelja e parimeve të barazisë dhe transparencës: Ky kriter shkel parimet e barazisë dhe transparencës që janë të përcaktuara në ligjin e prokurimit publik. Duke vendosur kërkesa të ngushta dhe të papërshtatshme, autoriteti kontraktues mund të favorizojë disa operatorë dhe të krijojë një treg të mbyllur për të tjerët. Kjo bie ndesh me synimin e ligjit për të garantuar një konkurrencë të hapur dhe të drejtë.

Pikat 15-17 në Aneksin 7 - "Ngarkues"

Kërkesa për ngarkues me tonazhe të specifikuar në këtë formë—"Ngarkues 25 deri 26t

- 3 copë", "Ngarkues 20 deri 23t - 3 copë", dhe "Ngarkues 6 deri 7t - 1 copë"— përbën një kufizim të konkurrencës dhe mund të konsiderohet si një kërkesë e tepruar dhe e kundërligjshme për disa arsye

1.Sasia e tepërt e ngarkuesve të kërkuar:

Për një projekt të vetëm, kërkesa për 7 ngarkues është jashtëzakonisht e lartë dhe mund të konsiderohet një kërkesë e tepruar. Kjo mund të krijojë një ndarje të pazakontë të tregut dhe të përjashtojë një pjesë të konsiderueshme të operatorëve ekonomikë që mund të kenë mundësinë për të realizuar projektin me një numër më të vogël ngarkuesish, por me pajisje të tjera të përshtatshme. Kërkesa për kaq shumë ngarkues mund të jetë një shenjë e përshtatjes së kushteve për disa kompani specifike, duke kufizuar mundësinë e konkurrencës të drejtë dhe të hapur.

2.Kufizimi i konkurrencës për shkak të tonazheve të ngarkuesve:

Diferenca në tonazhin e ngarkuesve të kërkuar është gjithashtu një element që kufizon mundësinë e konkurrencës. Kërkesa për ngarkues me tonazhe specifike të ngushta, si për shembull 25-26t dhe 20-23t, mund të jetë e panevojshme për realizimin e projektit dhe favorizon operatorët që disponojnë pikërisht këto pajisje. Kjo do të përjashtojë operatorët që mund të kenë ngarkues të cilësisë së kërkuar, por me tonazh më të madh ose më të vogël.

Ky lloj kërkesë i përshtatet një grupe të caktuar operatorësh dhe krijon një mundësi për manipulim të tenderëve, duke reduktuar mundësitë e një konkurrencë të drejtë dhe të hapur.

3.Përshtatja e kërkesave për operatorë të caktuar:

Kërkesa për specifikime të tilla të ngushta të tonazhit dhe për sasi të larta ngarkuesish mund të jetë një formë e përshtatjes së kushteve për disa operatorë ekonomikë të caktuar, të cilët mund të jenë të vetmit që mund të plotësojnë këto kërkesa. Kjo paraqet një shkelje të mundshme të parimeve të prokurimit publik, pasi nuk janë të garantuara mundësitë për ofertuesit e tjerë të cilët mund të ofrojnë pajisje të përshtatshme, por ndoshta me specifikime më të gjera ose me tonazh më të madh.

4.Shkelja e parimeve të barazisë dhe transparencës:

Këto kërkesa janë në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, veçanërisht parimin e barazisë dhe transparencës, të cilat janë thelbësore për një proces të drejtë të tenderimit.

Kërkesa për tonazhe të ngushta dhe për një numër të madh ngarkuesish mund të favorizojë operatorë të caktuar dhe të krijojë kushte të padrejta për pjesëmarrësit e tjerë, duke i përjashtuar ata që mund të ofrojnë pajisje të përshtatshme për projektin, por jo plotësisht të përputhshme me këto specifika të ngushta.

Pika 19 në Aneksin 7 - “Grejder (Makina për nivelizimin e rrugëve)”

Kërkesa për një numër të madh grejderësh për një projekt të vetëm (rrugë Lokale) krijon një pengesë të panevojshme për kompanitë që mund të kenë mundësinë për të realizuar projektin me një numër më të vogël grejderësh. Ky lloj kriteri favorizon vetëm ato kompani që disponojnë një flotë të madhe të pajisjeve, duke përjashtuar operatorët që mund të kenë pajisje të përshtatshme për projektin, por që nuk mund të pëmbushin këtë kërkesë për një numër të madh makinash.

Pikat 20-23 në Aneksin 7- Finishera

a.Finisher për shtrirjen e asfaltit mbi 25t,

b.Finisher për shtrirjen e asfaltit 16 deri në 18t,

c.Finishera për shtrirjen e asfaltit me pajisje percjellese GPS dhe laser 16 deri 18t

d. Finisher për shtrirjen e asfaltit 10 deri në 12t

Edhe kjo kërkesë, sikurse shumica e kërkesave të tjera, përveç se është në sasinë e kërkuar e kundërligjshme dhe e tepruar, kufizon konkurrencën dhe është e përshtatur. Ajo që është edhe më shqetësuese është diferenca që parashikohet dhe kufizimet në tonazhin e të njëjtëve, si dhe sasia e kërkuar prej 4 finisherash.

Pika 29 në Aneksin 7

Kamion me konstruksion-ndërtim kiper mbi 10m³, peshë e ngarkesës (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit, i cili ka afat valid të regjistrimit) – Kufizimi në m³ dhe sasia prej 22 kamionëve pengon konkurrencën dhe është totalisht e panevojshme dhe bie në kundërshtim të rrept me ligjin e prokurimit public dhe aktet nenligjore.

Ndërtimi I ndonjë autostrade nuk do të kërkonte 22 kamionë, kjo kërkesë është qesharake në të njëjtën kohë shqetësuese dhe diskriminuese karshi operatorëve ekonomik të kësaj fushe në Republikën e Kosovës. Është për të ardhur keq se edhe pas kësaj kërkesë për rishqyrtim ky kriter nuk është ndryshuar nga ana e autoritetit kontraktues.

Kërkesa për një numër të madh kamionësh mund të shkelë parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së hapur që janë thelbësore për një proces të drejtë të tenderimit.

Për të siguruar një konkurrencë të drejtë dhe transparente, dhe për të respektuar parimet e barazisë dhe për të shmangur diskriminimin, kërkojmë që ky kriter të rishikohet dhe të modifikohet. Numri i kamionëve duhet të jetë i përshtatshëm për nevojat reale të projektit dhe të mundësojë pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh ekonomikë, pa kufizuar mundësitë e konkurrencës për ata që kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin e punimeve, por jo 22 kamionë. Kjo do të ndihmojë në realizimin e një procesi të drejtë dhe të hapur tenderimi, duke u mundësuar operatorëve të ndryshëm të ofrojnë shërbime të cilësisë së kërkuar.

Pika 30 në Aneksin 7

Kërkesa për 8 autobetonierka mikser në një projekt të vetëm është një kërkesë e tepruar dhe kufizuese për disa arsye të rëndësishme:

1. Sasia e tepërt e kërkuar për autobetonierka mikser:

Kërkesa për 8 autobetonierka mikser është shumë e lartë për një projekt të vetëm dhe konsiderohet një kërkesë që nuk është e nevojshme për realizimin e projektit. Kjo kërkesë mund të përjashtojë operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë pajisje të përshtatshme, por që nuk disponojnë një numër të tillë të makinash. Kjo mund të krijojë një pengesë të panevojshme për kompanitë më të vogla, duke i ndaluar ato të marrin pjesë në tender dhe të ofrojnë shërbime të cilësisë së kërkuar.

2. Kufizimi i konkurrencës:

Një kërkesë e tillë mund të jetë diskriminuese, pasi kufizon mundësinë e konkurrencës dhe përjashton operatorët që mund të ofrojnë shërbim të njëjtë, por me një numër më të vogël autobetonierkash. Operatorët që disponojnë një numër më të vogël makinash, por që mund të realizojnë projektin në kohë dhe me cilësi të lartë, mund të përjashtohen për shkak të kërkesës për një numër të madh autobetonierkash. Kjo përbën një formë të përshtatjes së kushteve të tenderit për disa kompani dhe e bën më të vështirë për pjesëmarrësit e tjerë që kanë mundësi të përmbushin kërkesat e tjera të projektit.

3. Përshtatja e kërkesave për disa operatorë të caktuar:

Kërkesa për 8 autobetonierka mikser mund të jetë një përshtatje e kushteve të tenderit për disa operatorë të caktuar, të cilët mund të kenë në dispozicion këtë numër makinash.

Kjo krijon mundësi për manipulim të tenderëve dhe mund të favorizojë operatorët që mund të plotësojnë këtë kërkesë, duke përjashtuar operatorët që mund të ofrojnë një shërbim të cilësisë së kërkuar, por me më pak pajisje.

4. Shkelja e parimeve të prokurimit publik:

Ky kriter mund të shkelë parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së hapur, që janë të garantuara nga ligji për prokurimin publik. Kërkesa për një numër të madh autobetonierkash mund të favorizojë disa kompani dhe të eliminojë mundësinë për konkurrencë të drejtë, duke e bërë të vështirë për operatorët e tjerë të marrin pjesë në tender, edhe pse ata mund të ofrojnë shërbime të njëjtë cilësie, por me pajisje më të vogla ose më të përshtatshme për realizimin e projektit.

Pika tjetër e cila ngjall dyshime tek ne si operator ekonomik, është pika 48 tek aneksi 7 I dosjes së tenderit ku është kërkuar vetëm “Reflektometer” pa përcaktuar specifikat dhe sasinë. Paqartësia e specifikave shkelë parimin e transparencës të prokurimit publik, pasi operatorët e interesuar nuk mund të kenë informacion të mjaftueshëm për të ofruar një ofertë të drejtë dhe të plotë. Ky është një element që mund të krijojë pasiguri dhe të ndihmojë në përshtatjen e kërkesës për disa operatorë të caktuar, duke shmangur konkurrentët e tjerë. Për të siguruar një proces të drejtë dhe të hapur tenderimi, kërkohet që kërkesa për “Reflektometer” të përmbajë specifika të qarta dhe të detajuara, përfshirë sasinë e nevojshme dhe detajet teknike të pajisjes.

Përfundim

Kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit janë të tepruara dhe kufizuese, duke krijuar pengesa të panevojshme për konkurrencën dhe mundësitë e pjesëmarrësve të tjerë. Këto kërkesa diskriminojnë operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë shërbime të cilësisë së kërkuar, por që nuk disponojnë pajisje specifike ose numrin e nevojshëm të makinave të kërkuara. Përshtatja e kushteve të tenderit në favor të disa operatorëve të caktuar i redukton mundësitë për konkurrencë të drejtë dhe transparente, duke shkelur parimet e barazisë dhe transparencës që garantohen nga ligji për prokurimin publik. Kërkohet rishikimi i këtyre kriterëve për të mundësuar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh dhe për të siguruar një proces të drejtë dhe të hapur tenderimi.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 - Qëllimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1.Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2.Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3.Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondetpublike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktoj nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do

të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2, i cili thotë se:

Neni 28 Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do të parashtrijë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrijë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

2. Autoriteti kontraktues do t'ipërpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë nëpërputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim neni 1 - LPP - Qëllimi, Neni 6 - Ekonimiciteti dhe efikasiteti, Neni 7 - LPP - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi. Neni 28 - LPP - Specifikimet teknike, Neni 69 - LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale. Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e ofruara më lartë, kërkojmë nga OSHP që të marrë VENDIM të APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE: “JOOS&KRASNIQI-BAZË” SH.P.K dhe te ANULOHET njoftimi për kontratë dhe vendimi AK-së i datës 12.03.2025 DETYROHET autoriteti kontraktues që të rishikoj dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe të njejtat të bëhet në harmoni dhe konform dispozitave të LPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 26.03.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0197/25, ndërsa me datë 08.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0197 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0197 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues, ka parashtruar ankese në OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kritere diskriminuese.

OE ankues, ankesën e tij e parashtron në fazën e kritereve dhe në ankesën e tij i ka parashtruar pretendimet lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit për të cilat pretendon se janë diskriminuese dhe favorizuese.

OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues, në dosje të tenderit ka kërkuar:

- Udhëheqës i punishtes – Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit - Drejtimi Hidroteknik i certifikuar për menagjimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet në punë, minimum me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Me kete rast OE ankues, pretendon se kerkesa per menaxhim te resurseve ujore eshte kerkese diskriminuese dhe favorizuese sepse nuk ka te beje me natyren e aktivitetit te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar deshmit e ngarkuara ne sistemin e E-Prokurimit, sqaron se AK, pasi e ka aprovuar pjeserisht kerkesen per rishqyrtim te OE ankues ka bere disa ndryshime ne kerkesat e vendosura dhe njeri nga ndryshime ka te beje pikerisht (pretendimin) me kerkesen e cituar me larte, ku autoriteti kontraktues e ka hequr nje pjese te kerkeses se cituar me larte, konkretisht kerkesen per deshmin lidhur me menaxhim te resurseve ujore. Kerkese kjo e OE ankues, prandaj ky pretendim nuk trajtohet.

OE ankues, pretendon se kerkesa e vendosur ne dosje te tenderit, per tre inxhinier te diplomuar te ndërtimtarisë - drejtimin konstruktiv, eshte kerkese diskriminuese sepse sipas OE ankues, behet fjale per te njejtin kualifikim dhe pervojë pune.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qendron ky pretendim per arsye se AK, ne dosje te tenderit e ka len mundesin e lidhjes se kontrates mbi veper me inxhinieret e lartpermendur dhe se numri prej tre inxhinierëve i kerkuar ne dosje te tenderit nuk mund te konsiderohet diskriminues.

OE ankues, pretendon se AK ka kerkuar ISO standarde te cilat jane diskriminuese dhe favorizuese duke arsyetuar se janete fushes se IT-se dhe per organizata qe operojne ne industri te caktuara.

Iso standardet te cilat OE ankues pretendon se jane diskriminuese: Iso 28001:2007, IEC 27001:2013, Pass 99:2012, SA 8000:2014.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kerkesat per ISO standarde te cituara me larte, dhe pas nje kerkimi nga leshuesit e ketyre certifikatave, nuk qendron ky pretendim sepse ne asnjeren prej Iso standardeve te permendura me larte, nuk thuhet se jane te fushes se IT-se, por kane te bjene me fusha te ndryshme te menaxhimit te biznesit.

OE ankues, pretendon se me kerkesen per tonazhe te caktuara te pajisjeve te kerkuara ne dosje te tenderit, AK ka vendosur kriteret diskriminuese sepse sipas OE ankues kerkesa per pajisjen Buldozher me tonazh prej 25-26 t, pastaj Buldozher deri ne 7t, numri i madh i eskavatoreve, cilindrave, autobetonjerkave, kamioneve, finishereve, grejdereve, te kerkuar ne dosje te tenderit sipas OE ankues jane kerkesa diskriminuese.

Eksperti shqyrtues, vlereson se percaktimi i tonazhave prej/deri nuk eshte kerkese favorizuese per arsye se operatorët ekonomik pjesmarres kan mundesin me te madhe te sigurimit te pajisjeve, ndersa sa i perket numrit te madhe te pajisjeve, eksperti shqyrtues vlereson se kjo eshte ne pergjegjisi te autoritetit kontraktues dhe se te njejtin kan vepruar konform dispozitave të nenit 19.16 te Rregullores per prokurim publik.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të

Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur në tërësi besimin ekspertit shqyrtues sa i përket përgjigjeve në këto pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Po ashtu, duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Ankuesi pretendon se kërkesa që një udhëheqës të punishte me diplomë në Inxhinieri Ndërtimi ose Bachelor në këtë fushë, dhe përvojë pune për menaxhimin e resurseve ujore, cilësinë dhe shëndetin në punë, mund të duket jo shumë relevant për një tender me emrin "Rehabilitimi i rrugëve me asfalt". Paneli Shqyrtues njëjtë sikurse eksperti shqyrtues nuk do të ndalet në trajtimin e këtij pretendimi për derisa se AK ka bere disa ndryshime ne kërkesat e vendosura dhe njeri nga ndryshime ka te beje pikërisht (pretendimin) me kërkesën e cituar me larte, ku autoriteti kontraktues e ka hequr një pjese te kërkesës se cituar me larte, konkretisht kërkesën për dëshminë lidhur me menaxhim te resurseve ujore

Lidhur me pretendimin tjetër të ankuesit se kërkesa e vendosur ne dosje te tenderit, per tre inxhinier te diplomuar te ndërtimtarisë - drejtimit konstruktiv, është kërkesë diskriminuese sepse sipas OE ankues, behet fjale pre te njëjtin kualifikim dhe përvojë pune. Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të konstatimit të ekspertit shqyrtues, nuk e mbështet vlerësimin sipas të cilit Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore vetëm duke lënë mundësinë për lidhjen e kontratës mbi vepër me inxhinierët në fjalë. Paneli vlerëson se një kërkesë e tillë, në formën e saj aktuale, mund të paraqesë elemente të diskriminimit dhe të jetë në kundërshtim me parimet themelore të barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Paneli konsideron se vendosja e një kërkesë për përfshirjen e tre (3) inxhinierëve me kualifikime të njëjta për një aktivitet të prokurimit me vlerë relativisht të ulët, mund të rezultojë në favorizim të subjekteve të caktuara dhe të vendosë në pozitë të pafavorshme operatorë ekonomikë të tjerë. Kjo, veçanërisht, nëse krahasohet me praktikën në aktivitete të tjera të prokurimit të natyrës dhe vlerës shumë më të lartë (disa milionëshe), ku kërkesa të tilla nuk janë bërë.

Për rrjedhojë, kërkesa për tre inxhinierë të certifikuar në një procedurë të tillë mund të imponojë barrë të panevojshme mbi operatorët ekonomikë, të cilët, për të përmbushur këtë kriter, detyrohen ose të lidhin kontrata mbi vepër me individë që nuk janë të nevojshëm për realizimin e projektit, ose të krijojnë konsorciume, gjë që potencialisht rrit kostot dhe rezulton në oferta financiare më të larta ndaj Autoritetit Kontraktues.

Në këtë kontekst, Paneli Shqyrtues këtë pretendim e kualifikon të bazuar dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues, në bashkëpunim të ngushtë me njësinë kërkuese, të rishqyrtojë këtë kërkesë në mënyrë që të sigurohet se ajo është e justifikuar, proporcionale dhe në përputhje me parimet e nenit 7 të LPP-së. Kërkesat duhet të fokusohen vetëm në ato kritere që janë esenciale dhe të nevojshme për përmbushjen e objektivave të prokurimit, në përputhje me natyrën specifike të kontratës dhe në pajtim me nenin 51.3 të LPP-së, i cili kërkon përshtatshmëri dhe proporcionalitet në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit.

Lidhur me Iso standardet të cilat OE ankues pretendon se janë diskriminuese: Iso 28001:2007, IEC 27001:2013, Pass 99:2012, SA 8000:2014. Paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor nuk do të lëshohet në konstatim, sepse ky pretendim nuk është në kërkesë për rishqyrtim, dhe në kuptim të nenit 64.2 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, citohet se: *"Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues".* Si dhe në kuptim të nenit 109 të LPP, i cili citon: *"1.Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.2.Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji".* Si rrjedhojë ky pretendim nuk është i paraqitur fare në AK që me i plotësuar edhe kushtet e nenit 108/A dhe nenit 109 të LPP dhe të trajtohet pastaj nga OSHP.

Ankuesi pretendon se, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, lidhur me makineritë AK ka kërkuar mjete diskriminuese. Paneli Shqyrtues këtë pretendim e kualifikon pjesërisht të bazuar për faktin se AK si iniciues i këtij aktivitetit të prokurimit, konform nenit 27 dhe 69 të LPP të përcaktoj dhe të kërkoj mjetet e punës konform nevojave të cilat i parasheh për atë aktivitet, dhe është përgjegjësi e vetë AK përderisa në Dosje të Tenderit ka lënë mundësi, citat i Dëshmisë së kësaj kërkesë: *"Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit."*

Megjithatë, edhe këtë kërkesë AK duhet ta përmirësoj sepse si e tillë është në kundërshtim me Rregulloren NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ngase kërkesa sipas kësaj rregullorje për noterizim të dokumenteve është e panevojshme, citat: *"Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti / personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme."*

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë

kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitetet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit disa nga këto kriteret nuk janë konform nenit 51 të LPP dhe DT nuk është konform nenit 27 të LPP. andaj PSH obligon AK që të bëhen përmirësimet konform arsyetimit të dhënë në këtë vendim sipas vlerësimit të këtij paneli.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që duhet të përmirësohet Dosja e tenderit/ Njoftimin për Kontratë e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë” me numër të prokurimit: “632-25-1362-5-1-1, dhe AK të zgjasë afatin e ofertimit konform nenit 53.7 të LPP, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në plotni sipas dispozitave ligjore.

Paneli Shqyrtues vlerëson se duhet përmirësuar kriteret e Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë, për aktivitetin e prokurimit të lartcekur për shkak të kriterëve të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore andaj obligohet Autoriteti Kontraktues të bëjnë përmirësimet e kriterëve të Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: